



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/
PROCUREMENT REVIEW BODY

Në bazë të nenit 29 të Rregullores Nr. 02/2015 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe në pajtim me nenin 107 të Ligjit Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092, Organi Shqyrtues i Prokurimit shpall këtë :

SHPALLJE PUBLIKE

PËR KONKURSIN E EKSPERTËVE TEKNIK

Përmes së cilës i njoftojmë të gjithë kandidatët e interesuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim me nenin 29 të Rregullores Nr .02/2015 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës dhe Paneleve Shqyrtuese, me qëllim të mbrojtjes së interesave të Autoriteteve Kontraktuese do të përpilojë dhe mbajë një listë të **Ekspertëve Teknik**, të kualifikuar për shqyrtim të ankesave të Operatorëve Ekonomik, të cilët do të angazhohen gjatë shqyrtimit të ankesave dhe zbatimit të aktiviteteve të Prokurimit, konform kushteve të përcaktuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar që brenda afatit të caktuar në shpallje të paraqiten me dokumentacionin përkatës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët janë:

1.Të kenë të kryer Fakultetin e lëmive si në vijim:

- Ekonomist;
- Inxhinier të Ndërtimtarisë, Hidro, Konstruksion;
- Inxhinier të Arkitektures;
- Inxhinier të Maqinerisë;
- Inxhinier të Bujqësisë, Veterinarisë, Agrobiznes;
- Inxhinier të Gjeodezisë;

- Inxhinier të Xehtarisë;
- Inxhinier të Elektroteknikes;
- Inxhinier të Komunikacionit;
- Inxhinier të Teknologjisë Informative;
- Kimist/e;
- Farmacist/e.

2. E preferueshme është qe kandidatët të kenë tri (3) vite përvojë pune, profesionale dhe sidomos në lëminë e ekspertizës;

3. E preferueshme çertifikata e prokurimit e lëshuar nga IKAP-KRPP;

4. Të jenë të paanshëm në vendosje , me ngritje të lartë profesionale dhe të kenë njohuri lidhur me zbatimin e aktiviteteve të prokurimit;

5. Mos të kenë konflikt të interesit (sipas nenit 13 të Rregullores Nr. 02/2015 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës dhe Paneleve Shqyrtuese).

Kandidatët duhet t'i bashkangjesin aplikacionit këto dokumente :

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer;
- Vërtetimin mbi përvojën e punës;
- Vërtetimin për punën që kryen aktualisht;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikaten nga Gjykata që nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Vertetimin nga Policia;

Dokumentet dorëzohen në Organin Shqyrtues të Prokurimit / Zyra e Personelit (Adresa : Rruga “Migjeni” ish-Ndërtesa e Bankës se Lublanës, Kati i V-të, Prishtinë) ose përmes e-mailit : **arta.S.berisha@rks-gov.net**.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Për informata shtesë mund të kontaktoni me **Zyrën e Personelit** në numrin e telefonit : **038/212-360** prej ores **08:00 – 16:00**.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor prej dates : 13.05.2016 deri më datën : 27.05.2016 në ora 16:00.

Pas përfundimit të përpilimit të listës së **Ekspertëve Teknik**, Organi Shqytues i Prokurimit, do të informojë me shkrim të gjithë kandidatët të cilët kanë konkurruar për këto pozita **“Ekspert teknik në OSHP”**.

Prishtinë,

13.05.2016

